



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



ILD

INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË
TË DREJTËSISË



INSPEKTORATI I LARTË I
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË
INTERESAVE

Nr. 2643 Prot.
Tiranë, më 12.08.2023

Nr. 3206 Prot.
Tiranë, më 12.9.2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, (në vijim referuar si ILD)
përfaqësuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë Z. Artur Metani,

DHE

INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE, (në vijim referuar si
ILDKPKI) përfaqësuar nga Inspektori i Përgjithshëm Znj. Evgjeni Bashari,

DUKE VLERËSUAR se Inspektori i Lartë i Drejtësisë nga njëra anë dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave nga ana tjetër kanë si synim të përbashkët realizimin sa më të mirë të objektivave të tyre institucionale.

DUKE KONSIDERUAR qëllimin e përbashkët për forcimin e shtetit ligjor në luftën kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave, palët dëshirojnë të bashkëpunojnë në kuadrin e funksioneve të tyre ligjore, si edhe rekomandimin nr. 6, të rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2022 si dhe të rezolutës së Kuvendit të Republikës

së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2022”.

DUKE SYNUAR

që ky bashkëpunim do të rezultojë në një kontribut të efektshëm, për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave si dhe verifikimit të pasurive për subjekte në fushën e veprimtarisë së ILD-së. Krijimin e një marrëdhënie institucionale të qëndrueshme për të mbështetur synimet, objektivat dhe prioritetet strategjike të dy institucioneve.

DUKE RIAFIRMUAR

vendosmërinë për respektimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit të Procedurave Administrative, dhe kuadrit ligjor përkatës.

PALËT bien dakord të nënshkruajnë këtë marrëveshje e cila vendos bashkëpunimin konkret institucional ndërmjet tyre, në drejtim të shkëmbimit të ndërsjellët të informacionit dhe zgjerimin e formave të bashkëpunimit në të ardhmen, si më poshtë:

Neni 1

Baza ligjore

Kjo marrëveshje bazohet në të drejtat dhe detyrimet e palëve të përcaktuara në Kushtetutë në ligjet e tyre dhe aktet nënligjore në fuqi, konkretisht:

Nenit 147/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, neni 90, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2022”, si dhe Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2022”.

Neni 2

Qëllimi

1. Kjo marrëveshje lidhet ndërmjet palëve me qëllim të mundësimit të zbatimit të legjislacionit në fushat përkatëse, realizimin e bashkëpunimit të ndërsjellët në drejtim të

shkëmbimit të informacioneve mbi verifikimin e pasurisë, si dhe rastet e hasura në kushtet e konfliktit të interesave, të gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm, ndaj të cilëve Inspektori i Lartë i Drejtësisë në zbatim të funksioneve dhe kompetencave ligjore kryen:

- a) verifikimin e ankesave;
- b) hetimin e shkeljeve disiplinore;
- c) fillimin e procedimit disiplinor.

2. Shkëmbimin e përvojës ndërmjet inspektorëve që ushtrojnë veprimtarinë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe inspektorëve në ILDKPI, në kuadër të zbatimit të nenit 124/1 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për verifikimin e pasurisë dhe të figurës mbi subjektet objekt hetimi nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

3. Shkëmbimin e informacionit dhe konsultimin e akteve, si rregullore, vendime, udhëzime në fushën e kontrollit të pasurisë dhe konfliktit të interesave të nxjerra nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 3

Objekti

1. Palët do të bashkëpunojnë për shkëmbimin e informacionit në lidhje me konfliktin e interesave dhe të verifikimit të deklaratave të interesave private, ndaj subjekteve të përcaktuar në nenin 2, pika 1, të kësaj marrëveshje gjatë ushtrimit të detyrës.

2. Palët do të bashkëpunojnë për shkëmbimin e eksperiencave dhe përvojave mbi çështjet e deklarimit të pasurisë dhe rastet e hasura të konfliktit të interesave, duke përcaktuar modalitetet, tematikat, si edhe çdo proces tjetër në kuadër të forcimit të kapaciteve.

3. Palët do të bashkëpunojnë për shkëmbimin e informacionit dhe konsultimin e akteve si rregullore, vendime, udhëzime në sferën e kontrollit të pasurisë dhe konfliktit të interesave të nxjerra nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

4. Palët angazhohen të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit.

Neni 4

Kontributet e palëve

1. ILD dhe ILDKPKI marrin përsipër të informojnë reciprokisht njëri-tjetrin për rastet abuzive, korruptive apo për shkelje të kryera nga subjekte të cilët janë në fushën e veprimtarisë së përbashkët të dy institucioneve.

2. ILD dhe ILDKPKI marrin përsipër të bashkëpunojnë për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për shkëmbimin e përvojës, si dhe për t'i ofruar ndihmë për shërbime të ekspertizës për fushat respektive të veprimtarisë.

3. ILD dhe ILDKPKI angazhohen për të thelluar më tej bashkëpunimin midis tyre nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe konsultimit të akteve, si rregullore, vendime apo udhëzime në sferën e kontrollit të pasurisë dhe konfliktit të interesave të nxjerra nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

4. ILD dhe ILDKPKI angazhohen që të zhvillojnë aktivitete të përbashkëta në lidhje me çështje të fushave të veprimtarisë.

Neni 5

Bashkërendimi i punëve ndërmjet palëve

1. Palët caktojnë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit.

2. Palët brenda 20 ditëve nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes njoftojnë me shkresë zyrtare emrat e personave të kontaktit (numër telefoni, e-mail). Njoftimi i ndryshimit të personave të kontaktit do të kryhet në të njëjtën mënyrë.

3. Personat e kontaktit zhvillojnë takime ndërmjet tyre, në varësi të nevoja për shkëmbim informacioni.

4. Shkëmbimi i informacionit do të bëhet në formë shkresore dhe elektronike, por në çdo rast përmes personave të kontaktit.

5. Personat e kontaktit do të informojnë në vazhdimësi drejtuesit e dy institucioneve lidhur me problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje.

Neni 6

Administrimi i dokumentacionit dhe informacionit

1. Gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje të gjitha të dhënat e shkëmbyera ndërmjet palëve do të konsiderohen konfidenciale.

2. Çdo palë trajton informacionin në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, ligjit nr. 10/2023 "Për informacionin e klasifikuar", si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 7

Rishikimi dhe monitorimi i zbatimit

1. Palët bëjnë shtesa dhe ndryshime në këtë marrëveshje, bazuar në pëlqimin e ndërsjellë të paraqitur me shkrim.

2. Marrëveshje e miratuar dhe zbatimi i saj monitorohet në mënyrë periodike.

Neni 8

Përfundimi i Marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje mund të përfundojë nga secila Palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës tjetër, 3 (tri) muaj pas datës së marrjes të njoftimit të sipërpërmendur.
2. Deri në përfundim të kësaj marrëveshje, palët do t'u përmbahen termave dhe kushteve që rrjedhin prej saj, për sa i përket informacionit dhe dokumenteve të shkëmbyera përpara datës së përfundimit.

Neni 9

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje lidhet për një afat të pacaktuar.
2. Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj.
3. Marrëveshja, hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe dy të tjera në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u nënshkrua sot, në Tiranë, më datë 12 . 08.2023.

**PËR
ZYRËN E INSPEKTORIT TË
LARTË TË DREJTËSISË**

**INSPEKTORI I LARTË I
DREJTËSISË**

Artur Metani



**PËR
INSPEKTORIATIN E LARTË TË
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT
TË INTERESAVE**

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

Evgjeni Bashari

